

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË KËLCYRË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt: “Mbi vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fonde publike, taksat dhe tarifat vendore, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë bashkiake, etj” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 187, datë 31.12.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr.578/7, datë 31.12.2012, dërguar z. **Klement NDONI**, Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

A/1. Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me nr. 351/68 datë 2.2.2011 por të pa zbatuara.

Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109, nga Bashkia Këlcyrë të nxirren aktet administrative, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen ndalesat si më poshtë:

1. Në zbatim të ligjit nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” ndryshuar me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 neni 49 “Shkeljet dhe dënimet për regjistrimin”, pika 1, dhe në zbatim të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997, ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998 “Për organizimin dhe Funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës” etj, Zyra e Taksave Vendore të Bashkisë Këlcyrë të rakordojë me Policinë Bashkiake për të marrë masa:

-për licencimin e 20 subjekteve të pa regjistruara për vitin 2009.

-për vjeljen e vlerës 409,000 lekë për 408 familje të cilat rezultojnë debitorë për token bujqësore për vitin 2009.

2. Nga Bashkia Këlcyre të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimin e dëmit me vlerën **3,078,055** lekë, në mënyrë analitike si më poshtë:

2/a. Shuma 309,046 lekë, përfituar padrejtësisht pagesa për supervizim dhe kolaudim nga: [.....] në shumën 109,046 lekë dhe [.....] në shumën 200,000 lekë, në kundërshtim me kontratën datë 02.09.2008, dhe ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit " neni nr. 8, nr. 12, udhëzimin e K. M, nr. 2, datë 13.05.2005, "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit".

2/b. Shuma 76,406 lekë, për punime të kryera me të tretë si: [.....], shuma 31,436 lekë, [.....], shuma 7,000 lekë, [.....] në shumën 4,970 lekë dhe Përgjegjësin e Arsim Kulturës Astrit Çausi 33,000 lekë, në kundërshtim me Kreun e VI-të neni 13 dhe 14, "Verifikimi i vlerave materiale të furnizuara", të ligjit nr. 6942, datë 25.12.1984 "Për administrimin ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare", dhe udhëzimin e Ministrisë Financave shtesë nr. 02, datë 01.8.2006 "Për procedurat tatimore" pikën 1.2. dhe udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5, datë 10.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat".

2/c. Shuma 211,000 lekë, për mos pagim të taksës vendore, nga 10 persona sipas listës bashkëngjitur Raportit përfundimtar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 ndryshuar me ligjin nr. 9745, datë 28.5.2007 "Për sistemin e taksave vendore", udhëzimit e Ministrisë Financave dhe Ministrisë Brendshme nr. 655/1, datë 06.02.2007.

2/d. Shuma prej 574,360 lekë, nga firma ██████████ sh.p.k. Tiranë, për punime të pa kryera në objektin: "Qendra shëndetësore T2 fshat Këlcyrë" në vlerën 222,860 lekë. "Rikonstruksion i rrugës dhe trotuareve Këlcyrë-Përrenjas" Këlcyrë, në shumën 351,500 lekë, në kundërshtim me Kontratën nr. S`ka, datë 15.04.2009, dhe nr. S`ka, datë 02.09.2008.

2/e. Shuma prej 838,172 lekë, nga firma ██████████ shpk, Përmet, për punime të pa kryera në objektet: "Sistemim Asfaltim rruga blloku 5 kat Këlcyrë" Këlcyrë në shumën 356,390 lekë. "Sistemim Asfaltim rruga kryesore Klubi i Madh-Xhamia" Këlcyrë në shumën 481,782 lekë, në kundërshtim me Kontratë nr. s`ka, datë 22.05.2009, dhe nr. s`ka, datë 15.08.2008.

2/f. Shuma prej 165,800 lekë, nga firma ██████████ shpk, Ballsh, për punime të pa kryera në objektin "Ndërtim Kanali i devijimit të ujërave të shiut lagja Gur Këlcyrë", në kundërshtim me Kontratën nr. s`ka, datë 22.04.2009.

2/g. Shuma prej 753,271 lekë, nga firma ██████████ shpk, Përmet, për punime të pa kryera në objektin: " Rikonstruksion i shkollës së mesme qytet Këlcyrë", në shumën 408,359 lekë, "Rikonstruksion i rrugës Ura e Muço-Hyses-Mbrezhdan-Maleshovë-Vazhdim" Këlcyrë, në shumën 344,912 lekë, në kundërshtim me Kontratën nr. 3, datë 02.09.2008, dhe nr. s`ka, datë 10.06.2009.

2/h. Për ██████████, me cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, gjobë në masën 100,000 lekë për dëmin ekonomik shkaktuar në vlerën 222,860 lekë, në tenderin me objekt: "Qendra shëndetësore T2 fshat Këlcyrë".

2/i. Për ██████████, me cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, gjobë në masën 50,000 lekë për dëmin ekonomik shkaktuar në vlerën 1,405,944 lekë, në tenderin me objekt.

Deri datën 31 mars 2013

A/2.Masa organizative të rekomanduara nga auditimi aktual i KLSH-së me nr. 578/2, datë 26.10.2012 si më poshtë:

1. Autoriteti kontraktor Bashkia Këlcyrë duhet të dërgojë pranë Agjencisë së Prokurimit Publik regjistrat e parashikimit e të realizimit të prokurimeve publike sipas VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu I, pika 3/d.

Vazhdimisht

2. Në funksion të menaxhimit financiar dhe kontrollit, titullari i njësisë publike (Bashkisë), të hartojë politikat, të miratojë dhe monitorojë objektivat e njësisë publike që ai drejton, planet strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave. Të ngrihet grupi i menaxhimit strategjik të njësisë publike, i cili të përbëhet nga titullari i njësisë publike dhe të kryesohet prej tij sipas ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

Menjëherë

3. Nga bashkia të miratohet një sistem i rregullave specifike e të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, bazuar në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe UMF nr. 54, datë 15.7.2010 "Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Pika B.

Menjëherë

4. Të miratohen akte të brendshme administrative për të siguruar ngritjen dhe zbatimin e rregullave për kontrollin e brendshëm bazuar në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe Manualin "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

Menjëherë

5. Të hartohen nga bashkia dhe të depozitohen te Ministri i Financave vetëvlerësimi, deklarata vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike duke respektuar afatet sipas ligjit nr. 10296, datë 8.7.2011, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, nenit 18.

Menjëherë

6. Të merren masa nga titullari i Bashkisë për anulimin, revokimin apo shfuqizimin e të gjitha kontratave të lidhura për shitje trualli dhe të ndalohet lidhja e kontratave të mëtejshme nga Bashkia Këlcyrë si palë shitëse, pa pasur titull ligjor ku të rezultojë pronare e trojeve, përfituar, me anë të ligjit, vendimit gjyqësor apo aktit administrativ, sipas ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të pa luajtshme” neni 38, ligjin nr. 7980, datë 27.07.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, nenin 3, ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, nenin 55, ligjin nr. 7829, datë 1.06.1994 “Për Noterinë” nenin 5.

Vazhdimisht

7. Të merren masa që të ardhurat e parashikuara në paketën fiskale nga Këshilli i Bashkisë, të cilat nuk janë planifikuar nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të planifikohen e të arkëtohen në vitin në vazhdim.

Menjëherë

8. Të merren masa dhe të arkëtohen detyrimet si e ardhur e munguar e taksës së pastrimit, taksës pasurisë dhe taksës ndriçimit në vlerën totale 3,186 mijë lekë për vitin 2010-2011 dhe 9 mujorin e vitit 2012.

Menjëherë

9. Të merren masa, të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për kryerjen e kontrolleve për 53 subjekte, të cilët nuk kanë likuiduar as një detyrim në vlerën 1,792 mijë lekë, në vitin 2011-2012.

Menjëherë

10. Të merren masa dhe të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për planifikimin e taksës së tokës bujqësore si dhe arkëtimin nga planifikimi në vlerën totale 1,215 mijë lekë (853 mijë lekë mosplanifikim+362 mijë lekë mos arkëtim nga planifikimi) për vitin 2010-2011 dhe 9 mujorin e vitit 2012.

Menjëherë

11. Të merren masa dhe të ndiqen të gjitha procedurat ligjore deri në sekustrim, të 124 subjekteve debitorë në vlerën 3,595 mijë lekë për vitin 2010-2011 dhe 9 mujorin e vitit 2012.

Menjëherë

12. Të merren masa, të ndiqen të gjitha procedurat ligjore dhe të kontabilizohen gjobat për mos pagesë në afat për 47 subjektet në vitin 2010-2011 në vlerë 470 mijë lekë dhe për 28 subjekte në vlerë 280 mijë lekë në vitin 2012.

Menjëherë

13. Të merren masa, të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për kryerjen e kontrolleve dhe rivlerësimin e xhiros të 103 subjekteve të cilët e kanë deklaruar nën 2,000,000 në vitin 2011 dhe për 101 subjekte në vitin 2012 me qëllim rritjen e dyshemesë së tatimit mbi xhiro.

Menjëherë

14. Për ndryshime në paga, duhet të merret më parë miratimi i Këshillit Bashkiak, kompetencë e të cilit është miratimi i pagave dhe mënyrës së shpërblimit të punonjësve, sipas përcaktimit të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32 “Detyrat dhe kompetencat e këshillit komunal, ose bashkiak”, germa “ç”.

Vazhdimisht

15. Të miratohen në Këshillin e Bashkisë të specifikuara se cilat shpenzime do të kryhen nga Bashkia Përmet për sektorin e sportit dhe se sa do të jetë limiti buxhetor për secilin shpenzim.

Vazhdimisht

16. Të bëhet inventari i materialeve në përdorim të punonjësve, të krahasohet me gjendjen kontabile dhe të hapen kartelat personale për secilin punonjës për materialet që kanë në ngarkim dhe në përdorim.

Vazhdimisht

17. Të planifikohen nevojat vjetore për materiale të ndryshme, si kancelari, etj. dhe mbi bazën e vlerës së tyre e kufirit monetar të përcaktuar në VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të zgjidhet procedura e prokurimit për grup artikuj. Pasi për vitin 2010 u konstatua se janë blerë kancelari me procedurën e prokurimit të blerjeve me vlera të vogla vetëm tek një subjekt fizik me vlerë totale mbi 400 mijë lekë.

Vazhdimisht

18. Në rastet e blerjeve me vlera të vogla faturat tatimore të nënshkruhen nga blerësi, konkretisht komisioni i ngritur për blerjen e mallit, si dhe të shoqërohen me kuponin tatimor të kasës fiskale, të lëshuar nga shitësi.

Vazhdimisht

19. Dokumentacioni për pagesat e shërbimeve për udhëtim e dieta, veçanërisht për ekipin e futbollit të paraqiten sipas kërkesave të VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, kapitulli III, pika 3.2, si dhe shpenzimet e fjetjes, të paguhen kundrejt dokumentit tatimor përkatës të paraqitur nga hoteli, e shoqëruar me faturën e printuar nga kasa elektronike fiskale, për secilin person.

Vazhdimisht

20. Të merren masa që zhblokimi i garancisë të objekteve të kryhet në përfundim të periudhës së garancisë, pasi investitori, kolaudatori, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve të bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës duke mbajtur dokumentacionin përkatës si përcaktohet në udhëzim nr. 1, datë 22.2.2005 “Për disa shtesa në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar pika 10.

Vazhdimisht

Për ZVRPP Përmet:

1. Të merren masa nga regjistruesi i ZVRPP Përmet, që në zbatim të nenit 59 të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” të lëshojë urdhër për regjistrimin e kufizimit në seksionin përkatës të kartelës së pasurisë së paluajtshme, për 12 rastet e regjistrimit të kontratave të shitjes së trojeve publike nga Bashkia Këlcyrë për të cilat është konstatuar se janë tjetërsuar dhe regjistruar në kundërshtim me ligjin nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” neni 38, dhe UKM nr. 1, datë 31.1.2007 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, pika 3.

Menjëherë

2. Nga regjistruesi i ZVRPP Përmet, sipas nenit 20 pika dh, nenit 42 të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe UKM nr. 2, datë 2.12.2012, pika 6, të refuzohen të gjitha rastet e aplikimit për regjistrim të kontratave të shitblerjes së trojeve publike nga njësitë e qeverisjes vendore për të cilat konstatohet se janë lidhur në kundërshtim me ligjin nr. 7980, datë 27.07.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, nenin 3, ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, nenin 55, ligjin nr. 7829, datë 1.06.1994 “Për Noterinë” neni 54.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet

105-109, nga Bashkia Këlcyrë të nxirren aktet administrative, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen ndalesat në vlerën 3,179,052 lekë si më poshtë:

1. Për 37 subjekte në shumën **2,750,410** lekë, të cilat sipas 4 vendimeve të KRRT së Bashkisë Këlcyrë për vitet 2010 në shumën 337,510 lekë dhe vitin 2011 në shumën 2,412,900 lekë kanë përfituar leje ndërtimit, por nuk kanë arkëtuar 1% të vlerës së investimit sipas ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, neni 51, “Personi fizik dhe juridik para marrjes së dokumentit të lejes së ndërtimit duhet të paguajë 1% të vlerës së investimit që do të kryejë sipas preventivit të objektit”, shumë e cila duhet të arkëtohet nga subjektet përkatëse sipas listave.

Menjëherë

2. Për katër subjekte në shumën **370,512** lekë, të cilat sipas 4 vendimeve të KRRT së Bashkisë Këlcyrë kanë përfituar leje ndërtimit por nuk kanë arkëtuar vlerën e 2% dhe 3% taksa e ndikimit në infrastrukturë për vitet 2010 në shumën 2,000 lekë si më poshtë: [REDAKTUAR] me 3% taksa e infrastrukturës në vlerën 2,000 lekë dhe vitin 2011 në shumën 368,512 lekë si më poshtë: [REDAKTUAR] me 2 % taksa e infrastrukturës në vlerën 58,895 lekë, [REDAKTUAR] me 2% taksa e infrastrukturës në vlerën 90,866 lekë, [REDAKTUAR] me 2% taksa e infrastrukturës në vlerën 218,751 lekë në kundërshtim me vendimet e Këshillit Bashkiak nr. 1, dt. 22.01.2010 dhe konfirmim akti nga Prefekti me nr. 89/1, datë 10.02.2010, VKB nr. 3, datë 19.01.2011 dhe konfirmim akti nga Prefekti me nr. 100/1, datë 9.2.2011 dhe VKB nr. 2, datë 13.01.2012 dhe konfirmim akti nga Prefekti me nr. 75/1, datë 7.2.2012, shumë e cila duhet të arkëtohet nga subjektet përkatëse sipas listave.

Menjëherë

3. Për [REDAKTUAR] me detyrë arkëtare shuma prej **12,000** lekë, paguar në vitin 2010, si kompensime të prapambetura për vitet 2007 dhe 2008 pa ndonjë urdhër me shkrim dhe pa dokument vërtetues për gjendjen e papunësisë së bashkëshortit për atë periudhë, në zbatim të VKM nr. 499, datë 13.08.1998 “Për shpërblimin mujor të personave me më shumë se 3 persona në ngarkim në familje”.

Menjëherë

4. Për [REDAKTUAR] me detyrë ish kryetar si urdhërues dhe z. Hasim Shele ish përgjegjësi i Sektorit të Financës, si ekzekutues i pagesave, në shumën **46,130** lekë, pasi janë kryer në 3 raste pagesa për pajisjen e makinës me siguracion, me kartonin jeshil për daljen jashtë shtetit, pa përcaktuar se për cilin automjet bëhet siguracioni, si dhe nuk ka bashkëlidhur asnjë program bashkëpunimi me institucionet e huaja për të justifikuar nevojën e bërjes së siguracionit për daljen jashtë shtetit me makinë.

Menjëherë

C.MASA DISIPLINORE

1.Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, ligjit nr. 7829, datë 01.6.1994 “Për Noterinë”, bazuar në nenet, 6, 7, 8 dhe 14 sipas të cilëve Ministria e Drejtësisë ushtron kontrollin mbi veprimtarinë ligjore të noterëve, për përmirësimin e gjendjes, i rekomandojmë Ministrisë së Drejtësisë marrjen e masave përkatëse dhe të njoftohet Dhoma Kombëtare e Noterëve, për:

1. [REDAKTUAR] me detyrë noter,
2. [REDAKTUAR] me detyrë noter,

Pasi:

1-Nga ish kryetari i Bashkisë Këlcyrë [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] me detyrë ish Përgjegjësi i Sektorit të Financës në Bashkinë Këlcyrë janë lidhur kontrata shitje trualli në një sipërfaqe prej **3142.5 m²** (Brenda vijës kufizuese të qytetit Këlcyrë) me përfitues subjekte private një pjesë e të

cilave janë noteruar nga noteri [REDACTED] 5 kontrata shitblerje trualli me sipërfaqe **1243.8 m²**, [REDACTED] me sip. 691.7 m², [REDACTED] me sip. 92.1 m², [REDACTED] me sip. 125.5 m², [REDACTED] me sip. 115.5 m², [REDACTED] me sip. 219 m²) dhe [REDACTED] ka noteruar 5 kontrata shitblerje trualli me sipërfaqe **461 m²**, [REDACTED] me sip. 172 m², [REDACTED] me sip. 24 m², [REDACTED] me sip. 156 m², [REDACTED] me sip. 7.9 m², [REDACTED] me sip. 101 m²) në kundërshtim me ligjin nr. 7980, datë 27.07.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, nenin 3, “Derisa të përfundojë kompensimi fizik i ish-pronarëve.....”, ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, nenin 55, “Shitja e truallit pronë shtetërore ose publike bëhet në përputhje me ligjin nr. 7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”. Në rastet e ndërtimeve në prona publike, në çastin e marrjes së lejes së ndërtimit, personi fizik e juridik paguan 50 për qind të vlerës së truallit dhe, kur përfundon karabinaja e katit të parë, paguhet edhe pjesa tjetër e kësaj vlere”, ligjin nr. 7829, datë 1.06.1994 “Për Noterinë” nenin 54, “Akti noterial për tjetërsimin ose njohjen e pronësisë mbi sende të paluajtshme, ose të një të drejte reale mbi to, kryhet nga noteri, pasi të ketë verifikuar pronësinë e palës mbi sendin e paluajtshëm. Për këtë qëllim ajo i paraqet noterit dokumentet e pronësisë të lëshuara nga organi kompetent dhe, kur sendi nuk figuron i regjistruar, një vendim gjyqësor detyrimi për vërtetim pronësie. Noteri duhet të shënojë në akt verifikimin e bërë”, pasi “Bashkia Këlcyrë” **si palë shitëse** nuk disponon titull ligjor pronësie mbi trojet e shitura, përfituar sipas ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të pa luajtshme” neni 38, “Regjistrimi i fitimit të pronësisë me anë të ligjit, vendimit gjyqësor apo aktit administrativ, “në rastet kur shteti, personi fizik ose juridik **ka fituar të drejtën e pronësisë** mbi një pasuri të paluajtshme **me anë të ligjit, vendimit gjyqësor të formës së prerë për fitimin ose kalimin e së drejtës së pronësisë apo të aktit të një organi administrativ**, regjistruesi, mbështetur në këto akte të paraqitura nga personi i interesuar, bën regjistrimin, duke shënuar pronar shtetin, personin, fizik ose juridik, të cilit i ka kaluar e drejta e pronësisë”.

2-Mbështetur në nenin 25, germa a, të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe pikën 1 e 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 306, datë 13.6.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Largim nga shërbimi civil”, neni 25, pika 3, germa “d”,

1. Për [REDACTED], Përgjegjës i Sektorit Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit:

Pasi nga Bashkia Këlcyrë përfaqësuar nga kryetari [REDACTED] dhe Përgjegjësi i financës buxhetit dhe kontabilitetit [REDACTED], është lidhur një kontratë shitje trualli në një sipërfaqe prej **306 m²** (Brenda vijës kufizuese të qytetit Këlcyrë) me përfitues [REDACTED]. Kjo kontratë nuk është legalizuar me akt noterial.

Procedura e ndjekura për lidhjen e kontratës së shitblerjes së truallit publike nga Bashkia Këlcyrë me sipërfaqe **306 m²** është në kundërshtim me ligjin nr. 7980, datë 27.07.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, nenin 3 “Derisa të përfundojë kompensimi fizik i ish-pronarëve.....”, ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, nenin 55 “Shitja e truallit pronë shtetërore ose publike bëhet në përputhje me ligjin nr. 7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”. Në rastet e ndërtimeve në prona publike, në çastin e marrjes së lejes së ndërtimit, personi fizik e juridik paguan 50 për qind të vlerës së truallit dhe, kur përfundon karabinaja e katit të parë, paguhet edhe pjesa tjetër e kësaj vlere”, ligjin nr. 7829, datë 1.06.1994 “Për Noterinë” nenin 54, “Akti noterial për tjetërsimin ose njohjen e pronësisë mbi sende të paluajtshme, ose të një të drejte reale mbi to, kryhet nga noteri, pasi të ketë verifikuar pronësinë e palës mbi sendin e paluajtshëm. Për këtë qëllim ajo i paraqet noterit dokumentet e pronësisë të lëshuara nga organi kompetent dhe, kur sendi nuk figuron i regjistruar, një vendim gjyqësor për vërtetim pronësie. Noteri duhet të shënojë në akt verifikimin e bërë. Vërtetimi i nënshkrimeve”.

Nuk ka titull ligjor pronësie ku pala shitëse “Bashkia Këlcyrë” të rezultojë pronare e trojeve që ka shitur, përfituar sipas ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” neni 38, Regjistrimi i fitimit të pronësisë me anë të ligjit, vendimit gjyqësor apo aktit administrativ, “në rastet kur shteti, personi fizik ose juridik ka fituar të drejtën e pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme **me anë të ligjit, vendimit gjyqësor të formës së prerë për fitimin ose kalimin e së drejtës së pronësisë apo të aktit të një organi administrativ, regjistruesi, mbështetur në këto akte të paraqitura nga personi i interesuar, bën regjistrimin, duke shënuar pronar shtetin, personin, fizik ose juridik, të cilit i ka kaluar e drejta e pronësisë”.**

3- Mbështetur në kreu IV, neni 11, germa “e” dhe “ç” dhe nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Këlcyrë fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore:

“Zgjidhja e kontratës së punës”

1-Për ██████████, Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit të Territorit, Kadastrës dhe Pyjeve në Bashkinë Këlcyrë:

a. Për lejet e ndërtimit e dhëna për 37 subjekte në shumën **2,750,410** lekë, të cilat sipas 4 vendimeve të KRRT së Bashkisë Këlcyrë për vitet 2010 në shumën 337,510 lekë dhe vitin 2011 në shumën 2,412,900 lekë kanë përfituar leje ndërtimit, por nuk kanë arkëtuar vlerën 1% të vlerës së investimit sipas ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, neni 51, “Personi fizik dhe juridik para marrjes së dokumentit të lejes së ndërtimit duhet të paguajë 1% të vlerës së investimit që do të kryejë sipas preventivit të objektit”, shumë e cila duhet të arkëtohet nga subjektet përkatëse sipas listave.

b. Për lejet e ndërtimit e dhëna për katër subjekte në shumën **370,512** lekë, të cilat sipas 4 vendimeve të KRRT së Bashkisë Këlcyrë kanë përfituar leje ndërtimit por nuk kanë arkëtuar vlerën e 2 % dhe 3 % taksa e ndikimit në infrastrukturë për vitet 2010 në shumën 2,000 lekë si më poshtë: ██████████ me 3 % taksa e infrastrukturës në vlerën 2,000 lekë dhe vitin 2011 në shumën 368,512 lekë si më poshtë: ██████████ me 2 % taksa e infrastrukturës në vlerën 58,895 lekë, ██████████ me 2 % taksa e infrastrukturës në vlerën 90,866 lekë, ██████████ me 2 % taksa e infrastrukturës në vlerën 218,751 lekë në kundërshtim me vendimet e Këshillit Bashkiak nr. 1, dt. 22.01.2010 dhe konfirmim akti nga Prefekti me nr. 89/1, datë 10.02.2010, VKB nr. 3, datë 19.01.2011 dhe konfirmim akti nga Prefekti me nr. 100/1, datë 9.2.2011 dhe VKB nr. 2, datë 13.01.2012 dhe konfirmim akti nga Prefekti me nr. 75/1, datë 7.2.2012, shumë e cila duhet të arkëtohet nga subjektet përkatëse sipas listave.

2. ██████████, Përgjegjës i Sektorit të Partneritetit me Biznesin dhe Tarifat Vendore në Bashkinë Këlcyrë.

Për mos ndjekje të procedurave ligjore, mos mbajtje sipas ligjit të dokumentacionit për vitin 2010, mos kryerje kontrolli të subjekteve debitorë për 39 subjekte debitorë në vlerë 853 mijë lekë, gjatë vitit 2011 mos ndjekje të procedurave ligjore për 40 subjekte debitorë në vlerën totale 1.866 mijë lekë, për mos ndjekje procedurave ligjore në vitin 2012, për 45 subjekte në vlerë 876.500 lekë.

4.Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, neni 17 i ligjit nr. 33/2012, date 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” i rekomandojmë Kryeregjistrusit të ZQRPP Tiranë fillimin e procedurave për vlerësimin e përgjegjësisë, propozimin dhe dhënien e masës disiplinore për:

1. ██████████, me detyrë regjistruar në ZVRPP Përmet,
2. ██████████, me detyrë specialist topograf në ZVRPP Përmet,
3. ██████████, me detyrë specialist topograf në ZVRPP Përmet.

Pasi:

Janë pranuar dhe regjistruar 12 kontrata shitblerje të trojeve publike nga Bashkia Këlcyrë për të cilat është konstatuar se janë tjetërsuar dhe regjistruar në kundërshtim me ligjin nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të pa luajtshme” neni 38, dhe UKM nr. 1, datë 31.1.2007 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, pika 3, pa u verifikuar më parë elementët e formës dhe përmbajtjes së akteve të paraqitura për regjistrim.

Lidhja, noterimi i kontratave të shitjes së trojeve nga Bashkia Këlcyrë është në kundërshtim me ligjin nr. 7980, datë 27.07.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, nenin 3 “Derisa të përfundojë kompensimi fizik i ish-pronarëve.....”, ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, nenin 55 “Shitja e truallit pronë shtetërore ose publike bëhet në përputhje me ligjin nr. 7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”. Në rastet e ndërtimeve në prona publike, në çastin e marrjes së lejes së ndërtimit, personi fizik e juridik paguan 50 për qind të vlerës së truallit dhe, kur përfundon karabinaja e katit të parë, paguhet edhe pjesa tjetër e kësaj vlere”, ligjin nr. 7829, datë 1.06.1994 “Për Noterinë” nenin 54, “Akti noterial për tjetërsimin ose njohjen e pronësisë mbi sende të paluajtshme, ose të një të drejte reale mbi to, kryhet nga noteri, pasi të ketë verifikuar pronësinë e palës mbi sendin e paluajtshëm. Për këtë qëllim ajo i paraqet noterit dokumentet e pronësisë të lëshuara nga organi kompetent dhe, kur sendi nuk figuron i regjistruar, një vendim gjyqësor për vërtetimin e pronësisë. Noteri duhet të shënojë në akt verifikimin e bërë. Vërtetimi i nënshkrimeve”.

Nuk ka titull ligjor ku pala shitëse “Bashkia Këlcyrë” të rezultojë pronare e trojeve që ka shitur, përfituar sipas ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të pa luajtshme” neni 38, Regjistrimi i fitimit të pronësisë me anë të ligjit, vendimit gjyqësor apo aktit administrativ, “në rastet kur shteti, personi fizik ose juridik ka fituar të drejtën e pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme **me anë të ligjit, vendimit gjyqësor të formës së prerë** për fitimin ose kalimin e së drejtës së pronësisë **apo të aktit të një organi administrativ**, regjistruar, mbështetur në këto akte të paraqitura nga personi i interesuar, bën regjistrimin, duke shënuar pronar shtetin, personin, fizik ose juridik, të cilit i ka kaluar e drejta e pronësisë” dhe UKM nr. 1, datë 31.1.2007 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, pika 3, “Për verifikimin e elementeve të formës dhe të përmbajtjes së akteve noteriale, punonjësit e ZRPP-së, që përpunojnë kërkesat individuale për regjistrim, procedojnë duke verifikuar..... elementet e formës, në përputhje me ligjin nr.7829, datë 1.6.1994 "Për noterinë"..... vërtetësinë e regjistrimit ekzistues të pasurisë së paluajtshme, objekt kërkesë për regjistrim, në emër të tjetërsuesit, të përmendur në aktin noterial, nëse në aktin noterial të dhënat për pronën, pasuri e paluajtshme, janë të plota dhe lejojnë regjistrimin e saj.

D.KALLËZIM PENAL

Bazuar në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 248 “Shpërdorim detyrë”, të bëhet kallëzim penal ndaj ██████████, me detyrë ish Kryetar i Bashkisë, Këlcyrë dhe ██████████, me detyrë ish Përgjegjësi i Sektorit të Financës në Bashkinë Këlcyrë për konsumimin e figurës së veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuara nga neni 248 i ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal”, pasi nga auditimi rezultuan një sërë shkeljesh si më poshtë:

1-Nga ish kryetari i Bashkisë Këlcyrë [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] me detyrë ish Përgjegjësi i Sektorit të Financës në Bashkinë Këlcyrë janë lidhur kontrata shitje trualli në një sipërfaqe prej **3142.5 m²** (Brenda vijës kufizuese të qytetit Këlcyrë) me përfitues subjekte private në kundërshtim me ligjin nr. 7980, datë 27.07.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, nenin 3, “Derisa të përfundojë kompensimi fizik i ish-pronarëve.....”, ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, nenin 55, “Shitja e truallit pronë shtetërore ose publike bëhet në përputhje me ligjin nr. 7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”. Në rastet e ndërtimeve në prona publike, në çastin e marrjes së lejes së ndërtimit, personi fizik e juridik paguan 50 për qind të vlerës së truallit dhe, kur përfundon karabinaja e katit të parë, paguhet edhe pjesa tjetër e kësaj vlere”, ligjin nr. 7829, datë 1.06.1994 “Për Noterinë” nenin 54, “Akti noterial për tjetërsimin ose njohjen e pronësisë mbi sende të paluajtshme, ose të një të drejte reale mbi to, kryhet nga noteri, pasi të ketë verifikuar pronësinë e palës mbi sendin e paluajtshëm. Për këtë qëllim ajo i paraqet noterit dokumentet e pronësisë të lëshuara nga organi kompetent dhe, kur sendi nuk figuron i regjistruar, një vendim gjyqësor detyrimi për vërtetim pronësie. Noteri duhet të shënojë në akt verifikimin e bërë”, pasi “Bashkia Këlcyrë” **si palë shitëse** nuk disponon titull ligjor pronësie mbi trojet e shitura, përfituar sipas ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të pa luajtshme” neni 38, “Regjistrimi i fitimit të pronësisë me anë të ligjit, vendimit gjyqësor apo aktit administrativ, “në rastet kur shteti, personi fizik ose juridik **ka fituar të drejtën e pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme me anë të ligjit, vendimit gjyqësor të formës së prerë për fitimin ose kalimin e së drejtës së pronësisë apo të aktit të një organi administrativ, regjistruesi, mbështetur në këto akte të paraqitura nga personi i interesuar, bën regjistrimin, duke shënuar pronar shtetin, personin, fizik ose juridik, të cilit i ka kaluar e drejta e pronësisë”.**

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Bexhet Zeqiri, Vasillaq Peci, Hysen Metko dhe Ryisim Xhaja. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Albert Thoma, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT